



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____._____.2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 158, datë 26.08.2021, të paraqitur nga ankuesi E.K kundër Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) dhe Gjykatës Administrative të Apelit (në vijim GJAA) në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike”, “bindjes filozofike”, “gjendjes ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi E.K ka parashtruar se:

Me vendimin nr.51, datë 11.02.2021, ankuesi është skualifikuar nga KLGJ, si kandidat për magjistrat, profili gjyqtar dhe si pasojë e këtij vendimi ka ndërprerë Shkollën e Magjistraturës, të cilën e vazhdonte nga tetori 2020. Vendimi i KLGJ ka vendosur skualifikimin e tij për kriterin pasuror, pasi pasuria e tij nuk ka burime të ligjshme dhe cënon besimin e publikut. Ankuesi deklaroi se pasuria e tij në momentin e deklarimit ka qenë gjithsej rreth 25.000 euro dhe kredi bankar rreth 43.000 euro. Ky fakt ky nuk kontestohet nga KLGJ dhe ILDKPKI, por për këtë pasuri ai nuk ka burime të ligjshme justifikuese dhe ajo është e tillë që cënon besimin e publikut.

Sipas shpjegimeve të ankuesit, KLGJ kërkon raport nga ILDKPKI (jo detyrues), e cila ka konkluduar se ai nuk ka fshehje të ardhurash, nuk ka deklaram të rremë, nuk ka konflikt interesi, por ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për pasurinë e deklaruar. Kundër vendimit të KLGJ, ankuesi i është drejtuar Gjykatës, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës padisë.

Ankuesi deklaroi se nga rreth 80 kandidatë fitues të konkursit për magistrat për vitin 2020-2021, është i vetmi i skualifikuar për kriterin pasuror. Ai shprehet se, është kandidati më i varfër në pasuri nga 80 kandidatët e kualifikuar nga KLGJ apo KLP 2020-2021 dhe kandidati më i varfër nga 80 kandidatët e verifikuar dhe kaluar nga ILDKPKI për vitin 2020-2021, të cilët janë konsideruar pa probleme, me burim pasurie të ligjshme. Sipas ankuesit, në rastin e Demollarit kundër KLGJ, Gjykata ka mbajtur qëndrim krejt të kundërt me rastin e ankuesit kundër KLGJ, ndërkohë që kazusi është plotësisht i ngjashëm. Ankuesi shprehet se është me interes që të shihen të dy vendimet në mënyrë kritike, pasi e njëjta gjykatë për të njëjtën çështje mban dy qëndrime diametralisht të kundërta.

Ankuesi deklaroi se, në vitin 2017 ka kandiduar për organet e vetëqeveritjes dhe është kualifikuar për pozicionin Komisioner Publik nga OMN dhe lista unike i është përcjellë Kuvendit për votim. Nga kjo listë unike, ankuesi shprehet se është votuar nga anëtarët aktualë të KPK, IKP dhe KPA. Sipas tij, Rekomandimet e OMN për kualifikimin apo skualifikimin e kandidatëve janë marrë pas një procesi verifikimi për figurën dhe pasurinë e kandidatëve me qëllim primar konsolidimin e besimit të publikut në drejtësinë dhe reformën. Ky verifikim, siç thekson OMN është kryer me ndihmën e shumë institucioneve vendase. Pas këtij verifikimi janë përpiluar lista me kandidatë të kualifikuar dhe lista me kandidatë të skualifikuar për kriteret e pasurisë, figurës etj. Procedura e parashikuar për kalimin e një kandidati nga lista i skualifikuar në listën e kualifikuar parashikon një shumicë të cilësuar votash nga komisioni ad-hoc. Ankuesi thekson se, në vitin 2017 kur ai u kualifikua dhe u rekomandua nga OMN ishte “shumë më i pasur” se në 2020, kur u skualifikua nga KLGJ.

Në qershor të vitit 2021, Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurave për plotësimin e vendeve vakante për IKP dhe KPK dhe nëse ishte i interesuar, duhet të shprehte interesin brenda datës 30.06.2021, duke qenë se ishte pjesë e listës së përcjellë nga komisioni ad-hoc me nr.1553/5 prot, datë 31.05.2017. Ankuesi shpjegon se, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit verifikon nëse kandidatët e listës 2017, shprehin ende interes dhe plotësojnë ende kriteret dhe nuk kanë shkaqe penguese të ndodhura më pas në periudhën 2017-2020. Sipas ankuesit, periudha e verifikuar deri në 2017 merret e mirëqenë për përshtatshmërinë e kandidatëve. Ankuesi shprehet se, ka shprehur interes dhe i është nënshtruar votimit nga Kuvendi për vendet vakante në IKP dhe KPK. Sipas tij, pozita e Komisionerit Publik barazohet nga ligji me anëtarin e Gjykatës së Lartë.

Ankuesi pretendon se është paradoks që ai kualifikohet nga OMN në listën A+ për Komisioner Publik dhe kjo listë i përcillet Kuvendit për votim në 2017 dhe skualifikohet nga KLGJ në 2021 për në formimin fillestar dhe në qershor 2021 njoftohet nga Kuvendi për të shprehur interes për vendet vakante në IKP si pjesë e listës së vitit 2017.

Ankuesi shprehet se ka kërkuar nga ILDKPKI informacion lidhur me verifikimet e kryera nga ky institucion për kandidaturën e tij në vitin 2017, në funksion të procedurës së kryer nga OMN me ndihmën e institucioneve vendase. Në përgjigjen dërguar ankuesit, ILDKPKI është shprehur se ankuesi kishte deklaruar pasuri për herë të parë në vitin 2020, pra nuk ka deklarim pasurish në

2017. Ky fakt pranohet edhe nga ankuesi, por ky i fundit shprehet se kjo nuk përjashton faktin që ILDKPKI ka shërbyer si ndihmës për OMN në verifikimin e kandidatëve për pasurinë. Ankuesi shprehet se, fakti që ka një dosje verifikimi për personin e tij në 2017 pranohet edhe nga punonjës të ILDKPKI, por ky i fundit ka mbajtur qëndrim mohues edhe përpara KLGJ dhe Qendrës “ResPublika”, e cila operon në fushën e të drejtës së informimit.

Ankuesi shprehet se, KLGJ, u mjaftua vetëm me përgjigjen e ILDKPKI dhe praktikën e Kuvendit dhe hoqi dorë nga kërkimi i rekomandimeve të OMN dhe se sipas këtij institucioni verifikimi i kandidatëve, përfshirë edhe ankuesin në vitin 2017 ka qenë “formal” dhe jo verifikim i vërtetë i pasurisë dhe figurës dhe këtë e shpreh edhe në vendimin e saj nr.51/2021. Sipas ankuesit një qëndrim i tillë nga ana e KLGJ duket i qëllimshëm, tendencioz dhe krejt i pavërtetë, duke mohuar fakte dhe prova të qarta, pasi:

Së pari, janë fakte të njohura botërisht kualifikimi dhe skualifikimi i kandidatëve dhe roli i OMN në to dhe për vetë rëndësinë e tyre janë pasqyruar në Kushtetutë në Aneksin e saj;

Së dyti, janë pasqyruar gjerësisht në media dhe KLGJ apo Gjykata, nuk mund të kenë qenë indiferent ndaj këtij procesi që ka të bëjë pikërisht me këtë reformë dhe janë produkt i saj.

Së treti, pas vendimit të KLGJ dhe Gjykatës, me shkresat nr.455/2 dhe 455/3 të vitit 2021, nëpërmjet të cilave Kuvendi informon mbi procesin e vlerësimit kalimtar dhe vlerësimin e përditësuar nga OMN dhe Rekomandimet e Vëshguesve, del qartë se, kandidatët janë verifikuar imtësisht për pasurinë dhe figurën apo aftësitë profesionale nga OMN me ndihmën e institucioneve vendase me qëllim rritjen e besimit të publikut. Në këtë material, del qartë se disa kandidatë janë skualifikuar për kriteret pasuror apo figurën dhe pjesa tjetër e kandidatëve, përfshirë edhe ankuesin, janë rekomanduar për Komisioner Publik.

Së katërti, Kuvendi i Shqipërisë, në qershor 2021, thekson se vetëm ata kandidatë që janë kualifikuar dhe përcjellë me listën e komisionit ad-hoc në 2017 mund të shprehin interesin për vendet vakante. Sipas ankuesit, kërkohej vetëm një deklaratë nëse për periudhën nga 2017-2021 ka ndonjë shkak pazgjedhshmërie duke konsideruar periudhën përpara 2017 të ezauruar, në atë proces, ku ishin përfshirë shumë institucione kushtetuese dhe OMN në këtë procedurë, ankuesi shprehet se është votuar edhe emri i tij.

Sipas ankuesit, kemi të bëjmë me diskriminim të drejtpërdrejtë, të shumëfishtë, ndërsektorial, në forma të rënda për shkak të bindjeve politike, filozofike, gjendjes ekonomike dhe shkaqe të tjera të parashikuara nga nenet 1, 3, 3/1 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Ankuesi deklaron se, ka mbajtur një qëndrim publik dhe institucional pro reformës dhe vetëgut, kundër fenomeneve si, korrupsioni, pandëshkueshmëria, abuzimet dhe arroganca e zyrtarëve të lartë në vend dhe konkretisht:

- Në vitin 2021, i është drejtuar KLGJ me 10 letra të hapura, për kontakte të papërshtatshme dhe dyshime mbi korrupsion aktiv të zyrtarëve të lartë ndaj tij, gjatë procedurës së verifikimit 2020-2021. Këtu ankuesi shprehet se mbështet pretendimin e tij në kuadër të shkakut të pretenduar të diskriminimit në kuadër të “*çdo shkak tjetër*”, duke iu referuar denoncimit të tij kundër kontaktimit, kërkesave për rryshfet, procesit, procedurës nga KLGJ.
- Në vitin 2018, ILDKPKI, ka arkivuar një çështje të iniciuar nga ai kundër një ish-anëtari të kabinetit qeveritar (bëhet fjalë për mazhorancën aktuale) në kuadër të ligjit për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Ky ligj, parashikon mbrojtje nga hakmarrja, të cilën ankuesi shprehet se e ka kërkuar personalisht gjatë procedurës. Këtu ankuesi shprehet se, shkak i pretenduar “*çdo shkak tjetër*” i referohet denoncimit kundër abuzimeve në administratë ndaj një ish anëtari të kabinetit qeveritar të mazhorancës aktuale. Ankuesi pretendon se, ky sinjalizim nga ana e tij mund të ketë sjellë jo vetëm mungesën e mbrojtjes nga hakmarrja që parashikohet në ligj, por pikërisht hakmarrjen e ILDKPKI ndaj tij, e cila sipas ankuesit dihet që ka influenza politike dhe luhatje etike kur nxjerr të pastër zyrtarë dhe magjistratë me pasuri marramendëse dhe gjen probleme tek një kandidat pa pasuri, siç është ankuesi.
- Në vitin 2017, ai ka shfaqur gadishmëri për reformën në drejtësi dhe vlerësimin kalimtar Vetingun, duke kandiduar për organet e vetingut dhe më tej ka shprehur gadishmëri për të kontribuar në institucionet e reja si IKP, KPK, KPA, KLP, KLGJ, BKH. Në rrjetet sociale si *facebook*, në faqen e tij, ankuesi deklaron se, vazhdimisht mbron dhe inkurajon suksesin e reformës. Ankuesi shprehet se, ka mbledhur firma qytetarësh për të kandiduar i pavarur nga partitë kryesore në zgjedhjet lokale 2019, si revoltë qytetare për bojkotimin dhe përkeqësimin e demokracisë, sidomos kundër pengmarrjes së aspiratave të kombit shqiptar. Në rrjetet sociale, ankuesi shprehet se ka qenë aktiv, kritik dhe dyshues ndaj klasës politike në përgjithësi, e krerëve të saj në veçanti, duke denoncuar sidomos marrëveshjen dhe bashkërendimin e tyre të kamufluar, por efektiv, në dëm të reformës në drejtësi. Sipas ankuesit, reformën në drejtësi janë munduar ta zhdukin, ta vrasin pas shpine, ta përdhosin, përçudnojnë në mënyrë permanente dhe të organizuar, nga elita politike në kordinim të plotë konspirativ. Këtu ankuesi shprehet se, si shkak i pretenduar janë bindjet politike dhe filozofike, të cilat ai i ka shprehur në mendime dhe veprime konkrete. Sipas ankuesit, këto reagime spontane mund të kenë bezdisur armiqtë e reformës dhe të drejtësisë, të cilët duke dashur të kenë kontrollin absolut mbi institucionet e reja dhe të vjetra, nuk kanë dashur që të kenë kandidatë të pavarur prej tyre apo përkrahës të flaktë të reformës.
- Në vitin 2020, ankuesi shprehet se, pasuria, e cila ishte shkak kryesor i skualifikimit, si pa burime të justifikuara nga KLGJ, e bën atë kandidatin më të varfër nga të 80 kandidatët e kualifikuar nga KLGJ dhe KLP. Duke qenë më i varfri dhe njëkohësisht i skualifikuar për pasurinë, ankuesi ngre dyshime mbi seriozitetin dhe objektivitetin e ILDKPKI dhe KLGJ. Në këtë kontekst, ankuesi shprehet se një shkak tjetër i pretenduar është gjendja e tij ekonomike, si motiv përjashtimi, duke qenë më i varfri dhe si i tillë ai nuk ka si të çënojë besimin e publikut, çënon besimin e pasanikëve.

Ankuesi pretendon se, sa më sipër përbëjnë shkaqe diskriminimi ndaj tij. Nuk ka asnjë shpjegim tjetër bindës, duke ditur mënyrën se si u zhvillua procesi, duke kërkuar me ngulm

vetëm prova për të rënduar pozitën e tij dhe duke anashkaluar madje evituar provat favorizuese të kandidaturës së tij dhe sidomos një proces unik siç është ngritja e Organeve të Vlerësimit Kalimtar (Veting)

Sipas ankuesit, diskriminimi ndaj tij është bërë me udhëzime, në mënyrë të organizuar dhe i shumëfishtë, si hakmarrje për denoncimin me letra të hapura drejtuar anëtarëve të KLGJ për kontakte dhe korrupsion aktiv nga zyrtarë të lartë të KLGJ, përpara vendimarrjes së tyre. Sipas tij, nuk përjashtohen edhe “orientimet politike” nga lart mbi disa institucione ILDKPKI, KLGJ, GJAA, të cilat “u sforcuan” të mohojnë vetveten në verifikimet e 2017 kryer nga Kuvendi, Avokati i Popullit, ONM etj, në lidhje me ankuesin.

Një aspekt tjetër i dyshimtë sipas ankuesit është edhe fakti se në vitin 2020 KLGJ e ka skualifikuar edhe për Këshilltar Ligjor me argumentin se nuk ka 10 vjet eksperiencë pune, ndërkohë që po vetë KLGJ e kishte kualifikuar për Këshilltar Ligjor në vitin 2019. Edhe në kriteret e 2017 kërkohej mbi 10 vjet eksperiencë dhe ankuesi, shprehet se ishte kualifikuar.

Ankuesi pretendon se mund të ketë vend edhe për pikat 5, 10, 15, 16, 17, të nenit 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nëse bëhet një verifikim i thelluar dhe me spektër të gjerë dhe se plotësohen kërkesat e nenit 3/1 të ligjit.

Ankuesi deklaron se, kundër vendimit nr.19/2021 të Gjykatës Administrative të Apelit e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja është në shqyrtim. Ankuesi deklaron se i është drejtuar edhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg kundër shtetit shqiptar. Për aspekte të kësaj çështje, i është drejtuar Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë dhe kundër tij i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Për aspekte penale, ankuesi ka dhënë shpjegime përpara Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar SPAK etj. Gjithashtu, ankuesi i është drejtuar edhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit për të patur akses mbi të gjithë informacionin që ka lidhje me të, por pa sukses.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, marrjen e masave të mëposhtme:

- Të merren provat dhe të bëhet një hetim i thelluar dhe me spektër të gjerë.
- Të konstatohet diskriminimi në formë të rëndë, për disa shkaqe, ndërsektorial nga disa institucione kundër tij
- Komisioneri t’i drejtohet opinionit publik dhe institucioneve ndërkombëtare me qëllim sensibilizimin e tyre për këtë rast diskriminimi si këmbanë alarmi mbi revanshin e armiqve të reformës, të hapur apo të fshehtë kundër kujdo që guxon të luftojë, denoncojë dhe demaskojë plagë të rënda të shoqërisë si korrupsioni, pandëshkueshmëria, padrejtësia etj.
- Të zhvillojë një seancë dëgjimore publike për këtë rast.
- Të marrë masa me vendim për rivendosjen e gjendjes së mëparshme, pra lejimin që ankuesi të vijojë formimin fillestar pa vonesa të mëtejshme dhe dëmshpërblim për cënimet, si dhe

çdo masë tjetër që heq pasojat e diskriminimit dhe pengesat për t'u kualifikuar si magjistrat në profilin gjyqtar, sipas vlerësimit të Komisionerit (pika 11, neni 33, i ligjit)

- Si mjet i fundit, nëse Komisioneri vëren moszbatim të vendimit apo neglizhencë t'i drejtohet autoriteteve për heqjen e tagrave të institucioneve, siç parasheh pika 15, e nenit 33, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Bazuar në aktet e administruara ankuesi E.K, rezulton kandidat fitues për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021. Në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi i është nënshtuar procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës. Në përfundim të procesit të verifikimit, me vendimin nr.51, datë 11.02.2021, KLGJ ka vendosur: “Skualifikimin e kandidatit z. E.K, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020-2021”.

Ankuesi e ka kundërshtuar vendimin nr. 51, datë 11.02.2021 të KLGJ, pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Rezulton se me vendimin nr. 19, datë 17.03.2021, GJAA, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së ankuesit. Kundër këtij vendimi ankuesi deklaroi se ka ushtruar të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë.

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se është viktimë e diskriminimit dhe se skualifikimi i tij, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, ka ndodhur si pasojë e ndërveprimit të disa shkaqeve, të bindjeve politike, bindjeve filozofike, gjendjes ekonomike, për shkak të denoncimit mbi dyshime për korrupsion aktiv të zyrtarëve të lartë të KLGJ, gjatë procedurës së verifikimit, si dhe denoncimit kundër abuzimeve në administratë kundër një ish-anëtari të kabinetit qeveritar, të maxhorancës aktuale, të sinjalizuar prej tij pranë ILDKPKI.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për shpjegimin e diskriminimit”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe të sigurojë mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkaqet e pretenduara nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, **bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.**”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Ankuesi e ka drejtuar ankesën e tij për diskriminim jo vetëm kundër KLGJ, që është autoriteti që ka vendosur skualifikimin e tij, e për rrjedhojë ka cënuar interesin e tij, por edhe kundër ILDKPKI, për shkak të raportit të përgatitur nga ky autoritet, në kuadër të procesit të vlerësimit të ankuesit, të zhvilluar nga KLGJ.

Në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative,*

siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.” Ndërsa në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.”

Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret ILDKPKI, nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë palë në procedurën administrative të iniciuar nga ankuesi nëpërmjet ankesës së paraqitur. Procedura e verifikimit të cilës ankuesi i është nënshtruar në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është një kompetencë e KLGJ. Në përfundim të procedurës së verifikimit, KLGJ, ka disponuar me vendimin për skualifikimin e ankuesit, moment të cilin ankuesi e pretendon si momentin e diskriminimit të tij, pra momentin kur i është cënuar interesi, të cilin ai pretendon ta rivendosë në vend nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Komisionerit. Komisioneri vlerëson se nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe pretendimit për diskriminim kundër ILDKPKI, pasi nuk është ky institucion që ka cënuar interesin e ankuesit duke e skualifikuar, pasi skualifikimi i ankuesit është një kompetencë ligjore e KLGJ, e cila e ka ushtruar atë duke disponuar me vendimin nr. 51, datë 11.02.2021.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa nuk mund të drejtohet kundër ILDKPKI, për shkak se ky subjekt nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë palë në këtë procedurë administrative.

Vendimi nr.51, datë 11.02.2021 i KLGJ, i cili pretendohet nga ankuesi si momenti që ai është diskriminuar, është kundërshtuar nga ana e tij në GjAA. GjAA, në përfundim të shqyrtimit ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë, duke e konsideruar vendimin e KLGJ për skualifikimin e ankuesit si një akt administrativ të marrë konform ligjit.

Në vendim nr.19, datë 17.03.2021, GjAA shprehet se:

“Gjykata Administrative e Apelit vëren se, sikurse me të drejtë ka konkluduar edhe KLGJ, referuar informacionit të përcjellë nga ILDKPKI dhe Kuvendi i Shqipërisë, nuk rezulton që kandidati/paditësi E.K, të ketë kryer më herët deklaram pasurie dhe të ketë qenë për këtë shkak subjekt kontrolli pasuror”(faqe 44).

Në faqen 45, të vendimit të mësipërm GjAA shprehet se: “.....paditësi ka dështuar të vërtetojë me prova, ekzistencën e burimeve të ligjshme financiare, për justifikimin e pasurive të deklaruara”, çka do të thotë se gjykata ka vlerësuar se barra e provës bie mbi paditësin/ankuesin E.K.

Në ankesën e paraqitur, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, bazuar në faktin se, ai është kandidati më i varfër, për formimin fillestar për magjistrat, në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2020-2021 dhe i vetmi i skualifikuar për kriterin e pasurisë, ndërkohë që kandidatët e tjerë për magjistratë, të cilët janë kualifikuar, janë sipas tij shumë më të pasur se ai.

Në lidhje me këtë pretendim, GjAA shprehet se : *“... përfshirja në profilin e formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës nuk është garë mes të varfërve, kurorëzuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas identifikimit nga ky i fundit, të më të varfërit mes garuesve. Në këtë kontekst, lidhur me analizën e besimit të publikut, Gjykata Administrative vlerëson se, në kushtet kur ligji nuk bën dallim sa i takon procedurës së verifikimit, në kandidatë të pasur apo të varfër apo përmasës së pasurisë së tyre, pyetja që lipset ngritur konsiston në faktin e cënimit ose jo të besimit të publikut, në rastin e kualifikimit të një kandidati të vetëshpallur “ekonomikisht i varfër”, sikurse paditësi. Sa më sipër, Gjykata e Apelit Administrativ konfirmon qëndrimin e KLGJ-së, se: Vendimi objekt shqyrtimi është në përpjestim të drejtë me nevojën që e dikton atë, pikërisht në rekrutimin e magjistratëve që kanë gjeneruar të ardhura të justifikuara të ligjshme dhe kanë pasuri mbi të ardhura të justifikuara të ligjshme, si një nga shtyllat e besimit të publikut tek drejtësia”(faqe 45-46).*

Sa më sipër, Komisioneri konstaton se, të njëjtat pretendime mbi bazën e të cilave ankuesi mbështet pretendimin e tij për diskriminim kundër KLGJ, janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe për të cilat GjAA ka disponuar me vendimin e mësipërm. Kundër vendimit të GjAA, sikundër pranon vetë ankuesi, ky i fundit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Bazuar në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin përcaktohet se : *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.”*, si dhe bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e këtyre pretendimeve të ngritura nga ankuesi, pasi këto pretendime janë duke u gjykuar nga organet gjyqësore.

Ankuesi ka ngritur pretendimin për diskriminim edhe kundër GjAA. Në pretendimet e paraqitura ankuesi shprehet se, në rastin e Demollarit kundër KLGJ, gjykata ka mbajtur qëndrim krejt të kundërt me rastin e tij kundër KLGJ, ndërkohë që kazusi është plotësisht i ngjashëm. Sipas tij e njëjta gjykatë për të njëjtën çështje mban dy qëndrime diametralisht të kundërta.

Komisioneri vlerëson se, në cilësinë e një organi administrativ nuk ka asnjë kompetencë që të gjykojë në lidhje me ligjshmërinë e një vendimi gjyqësor, për të cilin mund të shprehet vetëm gjykata. Vendimet e dhëna nga ana e gjykatës kundërshtohen vetëm në rrugë gjyqësore, sipas parashikimeve respektive ligjore.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimet e ankuesit për diskriminim të paraqitura kundër Gjykatës Administrative të Apelit, nuk mund të merren në shqyrtim nga ana e tij, pasi nuk hyjnë në kompetencat e këtij institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi E.K kundër ILDKPKI, KLGJ dhe GJAA, nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 158 regj., datë 26.08.2021, të paraqitur nga ankuesi E.K kundër Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike, bindjet filozofike, gjendjes ekonomike dhe “çdo shkak tjetër”
Lloji i vendimit: Mospranim